95	Xhevat Adri		Po	33120	0.276	11.04	33120			0	0		0
96	Petrit Topi		Po	16560	0.138	5.52	16560			0	0		0
97	Eqerem Kapushi		Po	38640	0.322	12.88	38640			0	0		0
98	Ruzhdi Kapushi		Po	38640	0.322	12.88	38640			0	0		0
99	Emine Rusi		Po	22080	0.184	7.36	22080			0	0		0
100	Avdyl Baci		Po	22080	0.184	7.36	22080			0	0		0
101	Bujar Xhemollari		Po	22080	0.184	7.36	22080			0	0		0
102	Fuat Shkemi		Po	22080	0.184	7.36	22080			0	0		0
103	Ilmi Dushku			7872	0.0656	2.624	7872			0	0		0
104	Pellumb Qorllari			9804	0.0817	3.268	9804			0	0		0
105	Besim Dushku			1968	0.0164	0.656	1968			0	0		0
106	Isuf Isallari	Fatmir Duro		34692	0.2891	11.564	34692			0	0		0
107	Syrja Bregu	Fatmir Duro		30000		0	0	0.24	60	30000			0
108	Bexhet Pilinci			16560	0.138	5.52	16560			0	0		0
109	Sali Molla			11040	0.092	3.68	11040			0	0		0
110	Malor Rusi			22080	0.184	7.36	22080			0	0		0
111	Nuri Adri			38640	0.322	12.88	38640			0	0		0
112	Nuri Islam Adri			44160	0.368	14.72	44160			0	0		0
	Shuma			305352	24.7171		2966052	0.7		87500	0	0	0

Lidhja nr.3

PËRMBLEDHËSE E FORMULARIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET NË QARKUN E KORÇËS

Fshatrat	Fermerë	Sip e dëmtuar	Grurë	Vlera lekë	Foragjere	Vlera lekë	Jonxhë	Vlera në lekë	Hudhër	Vlera në lekë	Totali lekë
Sovjan	7	7.43	7.43	891600							891600
Gurishte		0		0							0
Veliterne		0		0							0
Leminot		0		0							0
Pirg	2	0.46	0.46	55200							55200
Zvirine		0		0							0
K.Pirg	9	7.89	7.89	946800	0	0	0	0	0	0	946800

PËRMBLEDHËSE E FORMULARIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET NË QARKUN E KORÇËS

Komuna: Pirg

N R	Emër, mbiemër i fermerit	Emër mbiemër qiramarrësit	Me tapi ose jo	Vlera e dëmit gjithsej në lekë	GRURË					
					Sip e dëmtuar ha	Shkalla e dëimit në %	Rend kv/ha	Prodhimi i dëmtuar kv	Çmimi lekë/kv	Vlera e dëmit lekë
	FSHATI SOVJAN									
1	Sezai Rakiplari		po	36000	0.3	100	40	12	3000	36000
2	Xhezar Rakiplari		po	12000	0.1	70	40	4	3000	12000
3	Hymet Kodra		po	14400	0.12	60	40	4.8	3000	14400
4	Selami Elmas Roko		po	120000	1	100	40	40	3000	120000
5	Myrteza Çaci		po	283200	2.36	100	40	94.4	3000	283200
6	Sali Kamber Abazllari		po	144000	1.2	100	40	48	3000	144000
7	Hetem Abazllari		po	282000	2.35	100	40	94	3000	282000
	Shuma			891600	7.43		40		3000	891600

PËRMBLEDHËSE E FORMULARIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET NË QARKUN E KORÇËS

Komuna: Pirg

NR	EMËR, MBIEMËR I FERMERIT	EMËR, MBIEMËR QIRAMARRËSIT	Me tapi ose jo	Vlera e dëmit gjithsej në lekë	GRURË					
					Sip e dëmtuar ha	Shkalla e dëm në %	Rend kv/ha	Prodhimi i dëmtuar kv	Çmimi lekë/kv	Vlera e dëmit lekë
	FSHATI PIRG									
1	Mustafa Mekollari		po	36000	0.3	100	40	12	3000	36000
2	Ali Hasanllari		po	19200	0.16	100	40	6.4	3000	19200
	Shuma			55200	0.46		40		3000	55200

VENDIM
Nr.1044, datë 22.12.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR LEVAN - TEPELENË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan - Tepelenë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 24 274 (njëzet e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e katër) m² tokë arë, me vlerë 5 243 618 (pesë milionë e dyqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, për sipërfaqen truell 3 615 (tre mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) m², me vlerë 648 382 (gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë, për kullotë, me sipërfaqe 15 488 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) m² me vlerë 1 564 288 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, për objekte me vlerë 3 879 913 (tre milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 11 336 201 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 11 336 201 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e një) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpronësimi të fillojë më 30.12.2010 dhe të përfundojë më 30.5.2011.

6. Pronarët e përmendur në listat që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë.

8. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tepelenë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tepelenë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tepelenë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
Rrethi: Tepelenë
Qarku: Gjirokastrë
Qyteti: Tepelenë

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR "DAMES - TEPELENË"

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Truall			Objekt Vlera lekë	Totali lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi	Vlera			
1	Hamet		Abedini	3574	1/64	79	150	11850		11850	Konfirmuar nga ZRPP
2	Toro	Ibro	Skenderi	3574	7/28	158	150	23700		23700	Konfirmuar nga ZRPP
3	Besnik		Zemani	3574	8/1	273	150	40950		40950	Konfirmuar nga ZRPP
4	Elidon	Leven	Malaj	3574	8/22	565	150	84750		84750	Konfirmuar nga ZRPP
5	Selaudin		Dalani	3574	8/23	74	150	11100		11100	Konfirmuar nga ZRPP
6	Hakani		Xhelaj	3574	8/99	218	150	32700		32700	Konfirmuar nga ZRPP
7	Firma "Graniti", Hekuran Aliaj			3574	8/42	197	150	29550		29550	Konfirmuar nga ZRPP
8	Ylli	Veliko	Gjoka	3574	8/38	155	150	23250		23250	Konfirmuar nga ZRPP
9	Besnik		Zemani	3574	8/32	130	150	19500		19500	Konfirmuar nga ZRPP
10	Agron		Hasa	3574	3/47	1152	150	172800	1551313	1724113	Konfirmuar nga ZRPP
11	Rasim		Ceka	3574	7/29	283	150	42450		42450	Konfirmuar nga ZRPP
12	Perparim		Shehu	3574	7/30	100	150	15000		15000	Konfirmuar nga ZRPP
13	Guri		Goxhaj	3574	8/66	62	150	9300		9300	Konfirmuar nga ZRPP
			TOTALI			3446		516900	1551313	2068213	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
Rrethi: Tepelenë
Qarku:
Komuna: Fshati Memaliaj Fshati: Fshat Memaliaj

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR "DAMES - TEPELENË"

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas	Are			Truall			Vlera Totale lekë	Shënime
	Emri		Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi	Vlera	Sip.m ²	Çmimi	Vlera		
1	Ismail		Sharaka	2647	165/109	77	235	18095				18095	Konfirmuar nga ZRPP
2	Teki		Dedgjoni	2647	165/107	55	235	12925				12925	Konfirmuar nga ZRPP
3	Emiliano	Mikel	Gjika	2647	445/9	301	235	70735				70735	Konfirmuar nga ZRPP
4	B.p.Servet Dedgjoni			2647	102	1483	235	348505				348505	Konfirmuar nga ZRPP
5	Muharrem	Tahir	Cela	2647	126/1				169	778	1E+05	131482	Konfirmuar nga ZRPP
6	Elmaz		Bega	2647	445/10	303	235	71205				71205	Konfirmuar nga ZRPP
7	Emiljano		Gjika	2647	445/11	359	235	84365				84365	Konfirmuar nga ZRPP
8	Myrto		Bega	2647	445/12	1779	235	418065				418065	Konfirmuar nga ZRPP
9	Neim		Dervishi	2647	445/2	2195	235	515825				515825	Konfirmuar nga ZRPP
			TOTALI			6552		1539720	169		131482	1671202	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Tepelenë

Qarku: Gjirokastër

Komuna: Qendër

Fshati: Mamaj

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR "DAMES - TEPELENË"

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas	Arc			Kullotë			Vlera Totale lekë	Shenime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi	Vlera	Sip.m ²	Çmimi	Vlera		
1	Fejzo		Mama	2582	160/17	2620	209	547580				547580	Konfirmuar nga ZRPP
2	Manxhar		Mama	2582	121/8	1273	209	266057				266057	Konfirmuar nga ZRPP
3	Kapo		Kamberi	2582	121/12	67	209	14003				14003	Konfirmuar nga ZRPP
4	B.pro.Gastare Balliu			2582	118/15	624	209	130416				130416	Konfirmuar nga ZRPP
5	B.pron.Ruka			2582	118/17	166	209	34694				34694	Konfirmuar nga ZRPP
6	B.pron.Ruka			2582	100/53	335	209	70015				70015	Konfirmuar nga ZRPP
7	Kujtim		Banushi	2582	100/56	263	209	54967				54967	Konfirmuar nga ZRPP
8	Hajri		Banushi	2582	100/55	496	209	103664				103664	Konfirmuar nga ZRPP
9	B.p.Sulo Hyseni			2582	19/3				7725	101	780225	780225	Konfirmuar nga ZRPP
10	B.p.Sulo Hyseni			2582	169/1				2433	101	245733	245733	Konfirmuar nga ZRPP
11	Nuri	Teme	Beta	2582	100/57	428	209	89452				89452	Konfirmuar nga ZRPP
12	Elmas	Dino	Beto	2582	118/9	1690	209	353210				353210	Konfirmuar nga ZRPP
13	Iirmi	Hasan	Banushi	2582	184/3	511	209	106799				106799	Konfirmuar nga ZRPP
14	Adriana		Saliaj	2582	184/18	151	209	31559				31559	Konfirmuar nga ZRPP
15	Dino	Ramo	Ruka	2582	100/54	536	209	112024				112024	Konfirmuar nga ZRPP
16	Dilaver	Servet	Elezi	2582	100/32	1649	209	344641				344641	Konfirmuar nga ZRPP
17	Elmaz		Beta	2582	100/30	514	209	107426				107426	Konfirmuar nga ZRPP
18	Rustem		Ruci	2582	100/29	374	209	78166				78166	Konfirmuar nga ZRPP
19	Bege		Ruka	2582	100/28	623	209	130207				130207	Konfirmuar nga ZRPP
20	Hasan	Sabri	Pila	2582	100/59	731	209	152779				152779	Konfirmuar nga ZRPP
21	Ilmi	Hasan	Banushi	2582	100/24	857	209	179113				179113	Konfirmuar nga ZRPP
22	Memo	Muharrem	Sula	2582	100/4	923	209	192907				192907	Konfirmuar nga ZRPP
23	Ago	Sabri	Leli	2582	100/3	628	209	131252				131252	Konfirmuar nga ZRPP
24	Dalip		Mama	2582	19/1	206	209	43054				43054	Konfirmuar nga ZRPP
25	Bashkpronaret, shehu, jonuzi etj			2582	91/1				5330	101	538330	538330	Konfirmuar nga ZRPP
26	Safet	Rasho	Balliaj	2582	118/19	873	209	182457				182457	Konfirmuar nga ZRPP
27	Muharrem Sadik		Ziaj	2582	118/8	130	209	27170				27170	Konfirmuar nga ZRPP
28	Alide	Rakip	Banushi	2582	100/22	732	209	152988				152988	Konfirmuar nga ZRPP
29	Luan		Berxhi	2582	100/2	265	209	55385				55385	Konfirmuar nga ZRPP
30	Fasli	Ali	Balliu	2582	81/1	57	209	11913				11913	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI					17722		3703898	15488		1564288	5268186	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Tepelenë

Qarku: Gjirokastrë

Komuna: Krahës

Fshati:Krahës i Poshtëm

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR "DAMES-TEPELENË"

Nr.	Pronari			ZK	Nr.pas.	Objekt	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				
1	Dervish		Shehu	2259	342/1	2 328 600	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali				2 328 600	

VENDIM

Nr.1045, datë 22.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.807, DATË 6.10.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN - TEPELENË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.807, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Vlera e tokës arë, nga 34 391 180 (tridhjetë e katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë, bëhet 36 697 484 (tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

b) Vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 63 521 159.52 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e dy) lekë, bëhet 65 827 463.52 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e dy) lekë.

2. Në listën e fshatit Malas, bashkëlidhur vendimit nr.807, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Çmimi i tokës arë, nga 659 (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë/m², bëhet 857 (tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë/m².

b) Vlera e tokës arë, nga 7 676 032 (shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e dy) lekë, bëhet 9 982 336 (nëntë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

c) Vlera e përgjithshme e shpronësimit për fshatin Malas, nga 8 201 887 (tetë milionë e dyqind e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, bëhet 10 508 191 (dhjetë milionë e pesëqind e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) lekë.

3. Diferenca prej 2 306 304 (dy milionë e treqind e gjashtë mijë e treqind e katër) lekësh, që i shtohet vlerës së përgjithshme të shpronësimit prej 63 521 159.52 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e dy) lekësh, të miratuar me vendimin nr.807, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

4. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, sipas masës së kompensimit të paraqitur në listën bashkëlidhur këtij vendimi, pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë të pronësisë nga pronarët respektivë.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Mallakastër

Qarku: Fier

Komuna: Fratar Fshati:Malas

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas	Are			Truall			Objekte Vlera lekë	Totali lekë	Shenime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi	Vlera lekë	Sip.m ²	Çmimi	Vlera lekë			
1	Shefit	Xhaferr	Skenderaj	2556	114/112	10	857	8570					8570	Konfirmuar nga ZRPP
2	Faslli	Hazis	Llanaj	2556	114/115	348	857	298236					298236	Konfirmuar nga ZRPP
3	Azbi	Dino	Skenderaj	2556	94/5	54	857	46278					46278	Konfirmuar nga ZRPP
4	Naile	Arshi	Saliaj	2556	94/22	1781	857	1526317					1526317	Konfirmuar nga ZRPP
5	Muharrem	Bekdash	Metaj	2556	334/1	2112	857	1809984					1809984	Konfirmuar nga ZRPP
6	Novrus	Qani	Bakaj	2556	334/5	10	857	8570					8570	Konfirmuar nga ZRPP
7	Hysnije	Muharrem	Jaupaj	2556	334/2	1085	857	929845					929845	Konfirmuar nga ZRPP
8	Pelivan	Hekuran	Jaupaj	2556	334/3	1517	857	1300069					1300069	Konfirmuar nga ZRPP
9	Barjame	Muhamet	Skenderaj	2556	117/3	824	857	706168					706168	Konfirmuar nga ZRPP
10	Pelivan	Rrapo	Skenderaj	2556	105/22	548	857	469636					469636	Konfirmuar nga ZRPP
11	Lefter	Hazis	Dhima	2556	124/15	1008	857	863856					863856	Konfirmuar nga ZRPP
12	Shefit	Xhaferr	Skenderaj	2556	105/11	1163	857	996691					996691	Konfirmuar nga ZRPP
13	Shefit	Xhaferr	Skenderaj	2556	108/24	1075	857	921275					921275	Konfirmuar nga ZRPP
14	Latif		Skenderaj	2556	108/23	113	857	96841					96841	Konfirmuar nga ZRPP
15	Pelivan		Skenderaj	2556	124/2				51	659	33609	259914	293523	Konfirmuar nga ZRPP
16	Bashkim		Skenderaj	2556								232332	232332	Leje ndertimi
		TOTALI				11648		9982336	51		33609	492246	10508191	

VENDIM
Nr.1051, datë 22.12.2010

PËR KALIMIN E PASURISË ME NR.5/409, NË ZONËN KADASTRALE NR.8513, TË RRETHIT DURRËS, ME SIPËRFAQE 1128.72 M², NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT (ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE) DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.536, DATË 1.5.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË BASHKISË DURRËS, TË QARKUT TË DURRËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 dhe të neneve 10, 12, 13 e 15/c të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pasurisë me numër 5/409, të ndodhur në zonën kadastrale nr.8513, të rrethit Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 1128.72 (një mijë e njëqind e njëzet e tetë pikë shtatëdhjetë e dy) m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Entit Kombëtar të Banesave), sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë e Durrësit, për ndërtimin dhe shitjen e banesave, në zbatim të politikave sociale të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

2. Pasuria me nr.5/409, me sipërfaqe 1128.72 m² (një mijë e njëqind e njëzet e tetë pikë shtatëdhjetë e dy), në zonën kadastrale nr.8513, në rrethin e Durrësit, hiqet nga lista e inventarit me nr.1207, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.536, datë 1.5.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të bashkisë Durrës, të qarkut të Durrësit”.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme, të Republikës së Shqipërisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucion i pushtetit qendror: Ministria e Punëve Publike e Transportit
Enti Kombëtar i Banesave
Fusha e përdorimit të pronës: truall

Nr.rendor	A			B			C			
	Zona Kadastrale&indeksi i hartës	Nr.i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip totale e pronës (m ²)	Nga sip totale: sa ndërtesë m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/entit me përgjegjësi administrative	Institucioni/entit përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8513 DR-H, I-6,7	5/409	Tokë truall	Durrës	1128.72	-	Truall i lirë	Shtet	Shtet	S'ka

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

1201	8513 H,I-4,5	1/394 1/399 1/407	Troje brenda territorit të bashkisë Durrës	Truall	Në territorin e bashkisë Durrës	2920	Infrastrukturë vendore	Bashkia Durrës	Bashkia Durrës	1/409; 1/411; 1/423; 1/455; 1/494; 1/518; 1/542; 1/549; 1/579; 1/581
1202	"	1/216 1/223 1/224		Truall dhe shesh midis pallatave	Lagje nr.18 Durrës	4267	"	"	"	1/249; 1/251; 1/256; 1/283; 1/355; 1/356; 1/359; 1/364; 1/366
1203	8513 F,G-6,7 H,I-6,7	2/177 2/180 2/191		Truall	Lagja nr.17 Durrës	17628.7	"	"	"	2/197; 2/204; 2/243; 2/452; 2/378; 2/386; 2/394; 2/604; 2/454; 2/477
1204	8513 F,G-6,7	2/90 2/92 2/98		"	"	17904	"	"	"	2/105; 2/110; 2/116; 2/121; 2/124; 2/129; 2/139; 1/153; 2/155; 2/176
1205	"	2/4 2/12 2/17		Truall dhe shesh midis pallateve	"	13224	"	"	"	2/19; 2/27; 2/34; 2/41; 2/43; 2/47; 2/62; 2/69; 2/75; 2/78
1206	8513 H,I-6,7	5/255 5/257 5/260		Truall	"	8514	"	"	"	5/262; 5/265; 5/268; 5/273; 5/277; 5/278; 5/283; 5/288; 5/300; 5/302; 5/306
1207	"	5/320 5/321 5/336		"	"	15833	"	"	"	5/344; 5/352; 5/358; 5/361; 5/380; 5/391; 5/409; 5/411; 5/146; 5/435; 5/446; 5/448; 5/161
1208	"	6/28 6/32 6/45		"	Në territorin e Bashkisë Durrës	3777	"	"	"	6/75; 6/83; 6/92; 6/98; 6/100; 6/101; 6/104; 6/111; 6/112; 6/149; 6/152

VENDIM
Nr.1055, datë 22.12.2010

PËR VENDOSJEN E OPONENCËS TEKNIKE PËR PROJEKTET E VEPRAVE TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 6, 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga subjekte fizike dhe juridike, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të bëhet oponencë teknike.

2. Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, oponenca teknike do të bëhet nga subjekte publike studimore/shkencore, të miratuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

3. Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike. Oponenca teknike është pjesë e dokumentacionit teknik të projektit.

4. Kërkesa për oponencë teknike bëhet nga investitori. Me miratimin e kërkesës, palët lidhin një aktmarrëveshje ndërmjet tyre, kushtet e së cilës miratohen nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit.

5. Tarifat e oponencës teknike të projekteve të veprave të ndërtimit, të zbatohen duke iu referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministrinë, institucionet qendrore dhe vendore, si dhe të gjitha organet e tjera investitore për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr.363, datë 18.7.2002 i Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

TARIFAT PËR OPONENCËN TEKNIKE PËR PROJEKTET E VEPRAVE TË NDËRTIMIT

Tarifat për oponencën teknike për projektet e veprave të ndërtimit i referohen tarifës në përqindje të projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, si më poshtë:

Kushtimi (milion lekë)	Tarifa (në %)
100,00	6.5
150,00	6.0
200,00	5.5
250,00	5.0
300,00	4.5
mbi 300,00	4.0

VENDIM
Nr.1056, datë 22.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.269, DATË 5.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA
NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN – VLORË (SEKSIONI I PARË)”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.269, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në listën që i bashkëlidhej vendimit në fuqi, disa prej pasurive, pronarëve dhe sipërfaqeve, sipas kolonës me emërtimin “Të dhënat e pasurive dhe pronarëve sipas saktësimeve të ZRPP-së”, ndryshojnë sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në pikën 3, ku përcaktohet sipërfaqja e përgjithshme, tokë arë, fjalët “... 253 036 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e gjashtë) m²...” zëvendësohen me “... 252 406 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e gjashtë) m²...”, dhe ku përcaktohet vlera e përgjithshme e shpronësimit, shifra “... 404 857 600 (katërqind e katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekësh ...” zëvendësohet me “... 403 849 600 (katërqind e tre milionë e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind) lekësh ...”.

2. Pronarëve të pasurive të paluajtshme, të cilat pësojnë ndryshime sipas kolonës me emërtimin “Të dhënat e pasurive dhe pronarëve sipas saktësimeve të ZRPP-së”, u takon masa e kompensimit, e paraqitur në këtë kolonë. Për ata pronarë, për të cilët nuk është bërë likuidimi për të gjithë sipërfaqen apo për një pjesë të saj dhe për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive, për të cilët në kolonën përkatëse është bërë shënimi “të pakonfirmuar”, “proces saktësimi”, “të paidentifikuar”, “shtet”, nëse nuk është bërë likuidimi i tyre, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë bërë regjistrimet apo pasi të ketë përfunduar procesi i saktësimit nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, dhe pasi të jenë konfirmuar të dhënat e plota dhe të sakta po nga kjo zyrë për titullin e pronësisë.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të marrë masat brenda kuadrit ligjor për përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, sipas të dhënave të pasqyruara në kolonën e emërtuar “Të dhënat e pasurive dhe pronarëve sipas saktësimeve të ZRPP-së”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve sipas pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

7. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e

shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Vendimi nr.823, datë 29.7.2009 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr.269, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i parë)”, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

